

Emri i Lëndës : E Drejta e Arbitrazhit							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 517	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Gentjan Skara, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		Lënda “E Drejta e arbitrazhit” luan një rol të rëndësishëm në formimin e juristëve që janë të fokusuar në aspektin ndërkombëtar të procedurave gjyqësore dhe të arbitrazhit. Lënda është konceptuar të trajtojë temat më kryesore në këtë fushë kaq të gjerë. Fillimisht, lënda do japë një shpjegim të përgjithshëm të koncepteve të përdorura, duke u ndalur më tej në përkufizimet dhe në fushën e veprimit të procedurave gjyqësore dhe të arbitrazhit. Më tej, lënda do të ezaurojë të gjitha llojet e procedurave që aplikohen në Gjykatat Ndërkombëtare të Arbitrazhit si Gjykata e Arbitrazhit në Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë, Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar në Londër, në Hong Kong, në Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelekualeetj. Krahas këtyre, lënda do të merret me hartimin e marrëveshjes së arbitrazhit, ligjin e zbatueshëm dhe me njohjen e vendimeve të huaja në gjykatat kombëtare. Gjithashtu, kursi do të japë njohuri specifike mbi analizimin e natyrës dhe efekteve të kontratës së arbitrazhit, adresimin e çështjeve si përcaktimi, kontestimi dhe shkarkimi si dhe detyrimet dhe të drejtat e arbitrave, palëve në mosmarrëveshje dhe institucioneve të arbitrazhit. Gjithashtu kursi, do te fokusohet edhe ne ligjin per arbitrazhin miratuar së fundmi nga Parlamenti i Shqipërise.					
Objektivat		Ky kurs synon: - T'i njohë studentët me konceptet e arbitrazhit ndërkombëtar si dhe të procedurave gjyqësore ndërkombëtare. - T'i njohë studentët me mënyrën e hartimit të kontratës së arbitrazhit si dhe me termat e përdorur në të. - T'u mundësojë studentëve njohuri në përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rastet e zgjidhjes së një konflikti me anë të procedurave të arbitrazhit si dhe të shpjegojë njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në vend. - Të ekzaminojë marrëveshjen e arbitrazhit nga një persektive e ligjit të arbitrazhit dhe e praktikës duke hedhur dritë mbi juridiksione të ndryshme në Afrikë, Azi, Europë dhe në Amerikën e Jugut. - Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar. - Të shpjegojë procedurat që ndiqen në Gjykatat Ndërkombëtare të Arbitrazhit si ajo e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, në Hong Kong, Londër etj. - Të zhvillojë tek studentët mendimin kritik në analizimin e çështjeve të arbitrazhit ndërkombëtar. - Të njohë studentët me disa nga rastet konkrete të kompanive shqiptare në Gjykatat Ndërkombëtare të Arbitrazhit.					
Konceptet Kryesore		1. Arbitrazh 2. Marrëveshje Arbitrazhi 3. Arbitër					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Njohuri të përgjithshme mbi arbitrazhin ndërkombëtar. Kjo javë do te shpjegoje silabusin dhe koncepte te pergjithshme te arbitrazhit nderkombetar. Gjithashtu studentet do te njihen me temat e tjera qe do te trajtohen ne kete kurs.						
2	Marrëveshjet Ndërkombëtare të Arbitrazhit: Kuadri Ligjor, Formimi dhe Vlefshmëria e Marrëveshjeve Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Kjo javë ofron një pasqyrë të përgjithshme të marrëveshjeve ndërkombëtare të arbitrazhit. Ai shpjegon kuadrin ligjor të marrëveshjeve ndërkombëtare. Për më tepër, mësimet fokusohen në formimin dhe vlefshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të arbitrazhit. Born, chapter 2 and 3						

3	Interpretimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Ky leksion fokusohet ne interpretimin e marreveshjeve nderkombetare te arbitrazhit. Gjate leksionet stilet e ndryshme të përdorura në interpretimin e marrëveshjeve të arbitrazhit ndërmjet palëve do te trajtohen. Gjithashtu shqetësimet që lindin gjatë interpretimit të marrëveshjeve do te diskutohen me studentet duke iu referuar rasteve specifike. Born, Chapter 4
4	Procedurat Ndërkombëtare të Arbitrazhit: Korniza Ligjore Kjo klasë trajton kuadrin ligjor duke u fokusuar ne aspektin e rregullave procedurale në arbitrazhin ndërkombëtar. Leksioni do te shpjegoje objektivat bazë të procesit të arbitrazhit ndërkombëtar, veçanërisht në krahasim me proceset gjyqësore në gjykatat kombëtare. Born, Kapitulli 6
5	Zgjedhja dhe Heqja e arbitrave ne Arbitrazhin Nderkombetar Ky leksion do te fokusohet ne zgjedhjen dhe heqjen e arbitrave ne arbitrazhin nderkombetar. Gjate leksionit do te diskutohen kriteret per zgjedhjen dhe heqjen e arbitrave. Born, kapitulli 7
6	Aspekte procedurale ne Arbitrazhin Nderkombetar Ky leksion do te trajtoje disa aspekte procedurale ne arbitrazhin nderkombetar. Studentet do te njihen me keto aspekte duke iu referuar rasteve te ndryshme. Born, Kapitulli 8
7	Zbulimi dhe marrja e provave ne arbitrazhin nderkombetar Ky leksion do te diskutoje zbulimin dhe marrjen e provave në arbitrazhin ndërkombëtar. Zbulimi i dokumenteve në arbitrazhin ndërkombëtar është një mjet në dispozicion të palëve për marrjen e provave faktike për të vërtetuar pretendimet e diskutueshme. Si një mjet për gjetjen e fakteve, zbulimi i dokumenteve mund të përshpejtojë zgjidhjen e çështjeve faktike që janë thelbësore për rastin. Born, Kapitulli 9
8	Provimi gjysmefinal
9	Konfidencialiteti dhe Transparenca ne Arbirtazhin Nderkombetar Ne këtë javë, studentet do te njihen me parimin e konfidencialitetit dhe transparencës në arbitrazhin ndërkombëtar. Konfidencialiteti është detyrë për të mos i dhënë informacion palëve të treta dhe, në kontekstin e arbitrazhit ndërkombëtar, mund të shtrihet tek palët, arbitrat, dëshmitarët, ekspertët ose anëtarët e institucionit të arbitrazhit. Konfidencialiteti shpesh përshkruhet si një nga arsyt kryesore për besimin e përdoruesve në arbitrazhin ndërkombëtar, pasi është një mjet për të ruajtur reputacionin dhe marrëdhëniet e palëve, si dhe për të kufizuar zbulimin publik të transaksioneve të ndjeshme të biznesit. Born, Kapitulli 10
10	Përfaqësues Ligjor dhe Përgjegjësia Profesionale në Arbitrazhin Ndërkombëtar Në këtë javë studentët do të njihen me përfaqësuesit ligjorë dhe përgjegjësinë profesionale në arbitrazhin ndërkombëtar. Studentët do t'u referohen disa rregullave dhe udhëzimeve te institucioneve ndërkombëtare te arbitrazhit. Born, kapitulli 14
11	Vendimet Ndërkombëtare të Arbitrazhit: Kuadri ligjor dhe anulimi Në këtë javë studentët do të njihen me vendimin e arbitrazhit. Vendimet e arbitrazhit janë përfundimtare dhe detyruese. Megjithatë, në rrethana të caktuara, ato mund të kundërshtohen ose anulohen përmes procedurave gjyqësore. Anulimi i vendimeve të arbitrazhit i referohet procesit ligjor me të cilin një gjykatë anulon ose anulon një vendim arbitrazhi që është nxjerrë nga një gjykatë arbitrazhi. Born, Kapitulli 15 dhe 16
12	Njohja dhe Zbatimi i Vendimeve Ndërkombëtare të Arbitrazhit Kjo javë fokusohet në njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Studentët do të njihen me Konventën për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj (Nju Jork, 1958). Born, kapitulli 17
13	Arbitrazhi ndërmjet shtetit dhe investitor Në këtë javë, studentët do të familjarizohen me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve investitor-shtet. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve investitor-shtet është një grup rregullash përmes të cilave shtetet (kombet sovraane) mund të paditen nga investitorët e huaj për veprime të caktuara shtetërore që ndikojnë në investimet e huaja direkte (FDI) të atij investimi. Born, kapitulli 18
14	Ligji i Arbitrazhit ne shqiperi Ne kete jave studentet do te njihen me Ligjin 52/2023 "Per Arbitrazhin ne republiken e Shqiperise". Ky ligj ka si qëllim krijimin e kuadrit ligjor për organizimin dhe zhvillimin e procedurave të arbitrazhit, si dhe garantimin e organizimit të zhvillimit të procedurave të arbitrazhit në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive. Ligjin 52/2023 "Per Arbitrazhin ne republiken e Shqiperise".
15	Raste të arbitrazhit në kompani shqiptare
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• Gary B. Born, International Arbitration Law and Practice, Wolter Kluwer 2021 • F.Tafaj Kola, Alternative Dispute Resolutions, Tiranë-Dea Print 2015		
Referenca të tjera	• Konventa e ICSID. “ Për mbrojtjen e investitorëve të huaj” • Ligji per Arbitrazhin		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë problemet që dalin nga raportet ndërkombëtare.		
2	Studentët do të kenë njohuri të mjaftueshme në fushën e arbitrazhit.		
3	Studentët do të përvetësojnë llojet e procedurave në juridiksione të ndryshme ndërkombëtare.		
4	Studentët do të njihen me specifikat e ligjit shqiptar mbi procedurat e arbitrazhit.		
5	Studentët do të jenë të gatshëm të hartojnë marrëveshje arbitrazhi për subjekte të ndryshme.		
6	Studentët do të jenë të aftësuar nga ana praktike në analizimin e çështjeve konkrete të kompanive shqiptare në arbitrazh.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		40	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		60	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	15	15
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			129
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.16
ECTS			5.00